



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III

Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale
Mbledhja nr. 6
Prishtinë, më 25 mars 2008, ora 11:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-10

PROCESVERBAL
i mbledhjes së Komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale

Në mbledhje morën pjesë: Sadik Idriz, Slobodan Petroviq, Teuta Hadri, Armend Zemaj, Gjylnaze Syla, Qamile Morina, Mimoza Ahmetaj.

Munguan: Rita Hajzeraj, Flora Brovina, Nurishahe Hulaj dhe Bujar Bukoshi.

Të pranishëm:

Nga Zyra e Komisioneve të Kuvendit: Shpresa Haxhijaj dhe Fatime Qorri;
Nga Zyra e Presidentit të Kosovës: Nexhat Shatri
Nga OSBE: Petrit Hysa
Nga NDI: Shefki Kastrati

Mbledhjen e kryesoi z. **Sadik Idriz**, kryetar i Komisionit
Komisioni zhvilloi punimet me këtë

REND DITE

1. Miratimi i rendit të ditës
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar
3. Shqyrtimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për skemën e ndihmës sociale në Kosovë
4. Shqyrtimi i Projektligjit për rehabilitimin profesional dhe për punësimin e personave me aftësi të kufizuara
5. Shqyrtimi i Projektligjit për përkrahje materiale të familjeve të fëmijëve me aftësi të përhershme të kufizuara
6. Të ndryshme

1. Miratimi i rendit të ditës

Mimoza Ahmetaj - Propozoi që pika e tretë e rendit të ditës të shtyhet për mbledhjen e ardhshme, me arsyetimin se është duke i pritur disa të dhëna nga Ministria e Punës dhe e Mirëqenies Sociale.

Gjynaze Syla - Tha se është e rëndësishme që Komisioni të ketë informatë për lëvizjet buxhetore që i ka paramenduar Ministria brenda buxhetit të vet. Ajo tha se meqë i kemi tri propozime të amendamenteve, është mirë që propozuesit si grup pune të takohen dhe në mbledhjen e ardhshme t'i paraqesin Komisionit propozim të përbashkët në mënyrë që të ndihmohet Komisioni për procedimin më të shpejtë të këtij Projektligji.

Armend Zemaj - Theksoi se mjetet materiale prej tre milionë nuk konsumohen, por barten në bazë të pikëve në rritjen e vlerës për ndihmë të atyre që kanë nevojë. Ai ishte i mendimit që propozuesit e amendamenteve ta bëjnë harmonizimin e tyre, pasi sipas tij disa prej propoziamendamenteve do të kenë implikime të mëdha buxhetore, ndërsa mjete shtesë nuk do të ketë.

Kryetari i ftoi anëtarët për të votuar lidhur me rendin e ditës.

Kryetari konstatoi se me shumicë votash u miratua rendi i ditës.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar

Procesverbali i mbledhjes së kaluar u miratua pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për skemën e ndihmës sociale në Kosovë

Kryetari - Tha se propozuesit e amendamenteve lidhur me këtë Projektligj do të takohen si grup pune dhe do t'i harmonizojnë amendamentet. Eventualisht do të konsultohen me përfaqësuesit e Ministrisë dhe në mbledhjen e radhës do t'ia paraqesin Komisionit propozimin e përbashkët. Ai e hapi diskutimin lidhur me këtë pikë të rendit të ditës.

Gjynaze Syla - Propozoi të votohet për grupin e punës që do të merret me harmonizimin e propozimamendamenteve.

Kryetari – I ftoi anëtarët për të votuar lidhur me propozimin që Mimoza Ahmetaj, Nurishahe Hulaj dhe Flora Brovina ta përbëjnë grupin e punës për harmonizimin e propozimamendamenteve dhe të konsultohen edhe një herë me përfaqësuesit e Ministrisë.

Kryetari konstatoi se me shumicë votash miratohet propozimi.

Armend Zemaj – E konsideroi të panevojshëm propozimin që sërish të dëgjohen përfaqësuesit e Ministrisë.

Qamile Morina - Tha se është mirë të sqarohet e gjithë kjo, duke u nisur nga fakti se vlera e përgjithshme është 5 milionë, ndërsa vlera e rritjes 2 milionë, atëherë ndryshimi ndërmjet kursimeve dhe rritjes së vlerës për këtë kategori është diku tre milionë. Ne duhet të kemi informata se ku do të përdoren këta 3 milionë të kursyer dhe a do të ketë rritje të tjera.

Teuta Hadri - Tha se raportuesit e projektligjeve mund të kontaktojnë në mënyrë interne me përfaqësuesit e ministrive për sqarime eventuale, në mënyrë që Komisioni të mos humbë kohë.

4. Shqyrtimi i Projektligjit për rehabilitimin profesional dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuara

Kryetari – I ftoi anëtarët e Komisionit që propozimamendamentet për këtë Projektligj t'i dorëzojnë në mënyrë elektronike te raportuesja, me qëllim të harmonizimit dhe të përgatitjes së Projektligjit për mbledhjen e radhës.

Teuta Hadri – I paraqiti amendamentet e saj: Kapitulli I, neni 2 “*Qëllimi i këtij Projektligji...*” në rreshtin e fundit pas fjalës nxitje të shtohet shprehja “*si dhe përgatitjen profesionale*”. Kapitulli II, neni 3 “*Departamentet për Çështje Sociale, zyrat komunale, Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Punës dhe e Mirëqenies Sociale, Qendra e Aftësimin dhe e Rehabilitimit*”, të ndërlidhen në një “*Qendër Koordinuese*” - të jetë kjo një ndërlidhje ndërministrore, në mënyrë që kjo kategori e njerëzve të mos keqtrajtohet prej një organi në tjetrin. Kjo qendër drejtpërdrejt i përgjigjet Qeverisë. Ajo gjithashtu propozoi që në këtë Projektligj si kategori e veçantë të përfshihet edhe “*kategoria e të verbërve*”, sigurimi i gjuhës dhe i shenjave të fjalorit të të verbërve-alfabetit të Brajtit - prej moshës 7-18 vjeçare e jo siç parashihet në Projektligj prej moshës 15-18 vjeçare.

Gjynaze Syla - Ishte e mendimit që Komisioni duhet të merret me çështjen nëse këta persona do të quhen persona me aftësi të kufizuara ose persona me nevoja të veçanta, duke e pasur parasysh faktin se këto dy projektligje kanë të bëjnë me këtë kategori.

Mimoza Ahmetaj - Tha se në të gjitha asociacionet këta persona e quajnë veten persona me aftësi të kufizuara.

Teuta Hadri – I njoftoi anëtarët e Komisionit se edhe në mandatin e kaluar janë organizuar, madje edhe dëgjime publike se si të quhet kjo kategori e njerëzve. Nga vetë përfaqësuesit e kësaj kategorie është vendosur që ky emërtim të jetë *persona me aftësi të kufizuara*.

Armend Zemaj - Tha se Komisioni duhet të sqarojë si të quhet kjo kategori e njerëzve, për arsye se në disa projektligje këta quhen persona me nevoja të veçanta.

Qamile Morina - Mendon se, duke pasur parasysh terminologjinë në botë, emërtimi person me aftësi të kufizuara është mjaft i arsyeshëm.

5. Shqyrtimi i Projektligjit për përkrahje materiale të familjeve të fëmijëve me aftësi të përhershme të kufizuara

Kryetari - Tha se raportuesja e këtij Projektligji mungon. Ai i ftoi anëtarët e Komisionit që propozimamendamentet t'i dorëzojnë me shkrim te raportuesja, në mënyrë që edhe ky Projektligj të procedohet tutje. Ai e hapi diskutimin lidhur me këtë pikë të rendit të ditës.

Qamile Morina - Tha se Projektligji për përkrahje materiale të familjeve të fëmijëve me aftësi të përhershme të kufizuara nuk ka paraparë kritere për përcaktimin e aftësisë së kufizuar, domethënë nuk ka kategorizim. Ndërsa, propozimamendamentet ajo do t'i dorëzojë me shkrim.

Mimoza Ahmetaj - Lidhur me atë që parashtrori deputetja Qamile Morina, tha se në Ligjin për skemën e ndihmës sociale është paraparë shkalla e invaliditetit që është 80%. Ajo tha se kjo është një ndër lidhshmëri e ligjeve.

6. Të ndryshme

Kryetari – I njoftoi anëtarët e Komisionit se e ka pranuar një kërkesë nga drejtori i Qendrës Emergjente në QKUK. Ai tha se në një nga mbledhjet e ardhshme do të ftohen për t'u dëgjuar drejtori i QKUK-së, ministri i Shëndetësisë si dhe drejtori i Qendrës Emergjente, në mënyrë që të jemi të informuar më drejtpërdrejtë për problemin. Në mbledhjen e ardhshme do të diskutohet se si do të vepohet më tutje lidhur me këtë çështje.

Qamile Morina - Ishte e mendimit që Kuvendi i Kosovës të formojë një komision hetimor për QKUK-në, duke e pasur parasysh që kjo qendër ka probleme të mëdha.

Mbledhja e radhës do të mbahet të martën e ardhshme.

Kryetari e shpalli mbledhjen të mbyllur në orën 12:10.

Përgatitur nga

Fatime Qorri- zyrtare ligjore

Zyra e Komisioneve të Kuvendit

*Kryetari i Komisionit,
Sadik Idriz*